

URDHËR
Nr. 40, datë 5.4.2024

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARISË
ADMINISTRATIVE TË AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE
KREDIVE TË PAKTHYERA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të neneve 22 dhe 23, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për ushtrimin e mbikëqyrjes institucionale të veprimtarisë administrative të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), te znj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave, deri në emërimin e titullarit të AMGKP-së, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet znj. Risena Xhaja, të ushtrojë kompetencat e mbikëqyrjes së këtij institucioni sipas ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Financave për komunikimin e këtij urdhri, si dhe Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
Ervin Mete